

### Informatat mbi grantin

Instrumenti:	Grant institucional
Organizata Implementuese (përfshirë partnerin nëse është e aplikueshme):	Organizata Kosovare per Talent dhe Arsim - TOKA
Kontaktet e organizatës: Adresa, email, telefonat, web faqja	Meto Bajraktari Street No 4-1 10000 Prishtina, Kosova +383 38 704 560 www.toka-ks.org
Kohëzgjatja:	Data e fillimit: 01.01.2021 Data e përfundimit: 31.12.2023
Buxheti i përkrahur nga programi:	€ 114,370.00
Buxheti total:	€ 858,379.96
Shtirja gjeografike:	Kosovë Selia e TOKA është në Prishtinë, por shumica e aktiviteteve të saj zhvillohen jashtë Prishtinës direkt në komunitetet me nevojë. TOKA mbështetë 30+ Klube të Vullnetarizmit Edukativ (VE), të udhëhequr nga vullnetarë të rritur në Deçan, Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Hani Elezit, Kaçanik, Kamenice, Lipjan, Prishtinë, Pejë, Podujeva, Skenderaj, Suhareka, Viti, Vushtrri . 26% e këtyre Klubeve janë në zona rurale, dy klube përfshijnë anëtarë të komunitetit shumicë dhe pakicë, dhe mbi 60% e anëtarëve janë vajza.
Grupet e synuara:	1. Të rinjtë adoleshentë (13-17 vjeç) – që vijnë nga zona të marginalizuara në Kosovë. Këta janë të rinj me potencial për lidërsip, dhe për të krijuar impakt pozitiv në komunitetin e tyre; ata vijnë kryesisht nga zonat rurale / provinciale dhe ku shumica janë vajza. 2. Mësuesit dhe punonjësit e rinisë - të cilët punojnë vullnetarisht për të paktën një vit shkollor për të formuar një Klub të Vullnetarizmit Edukativ. Ata takohen çdo javë me të rinjtë - me qëllimin kryesor të identifikimit të një problemi të komunitetit, pastaj zhvillimin dhe zbatimin e një projekti që e zgjidh atë problem.
Përmbledhje e intervenimit:	Qëllimi ynë është që të rinjtë me mundësi më të pakta të zhvillojnë kapacitete për t'u bërë agjentë të ndryshimit pozitiv, përmes metodave inovative të arsimit dhe vullnetarizmit afatgjatë.

Bashkëfinancuar nga:



Potenciali i të rinjve të Kosovës është shumë i nënshfrytëzuar për shkak të një sistemi arsimor që nuk arrin t'i përgatisë ata për shoqërinë dhe treguen e punës të shekullit 21. Të rinjtë që vijnë nga zona të marginalizuara (për shkak të rrethanave socio-ekonomike, gjinore, etnike) e kanë praktikisht të pamundur të 'ndryshojnë yjet e tyre' dhe të kenë një jetë më të mirë se prindërit e tyre.

Ne kërkojmë të arrijmë këto rezultate specifike:

1. Edukimi dhe fuqizimi i të rinjve - përmes programeve të Ndërtimit të Kapaciteteve – kampe, trajnime, ekskurzione educative dhe shkëmbime ndërkombëtare

2. Vullnetarizmi afatgjatë - programi kryesor i TOKA për të rritur angazhimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve është përmes Klubeve të Vullnetarizmit Edukativ, të cilat momentalisht shtrihen në mbi 10 Komuna të Kosovës.

3. Kapacitete të ngritura për mësimdhenës - ka shumë mësues të motivuar që duan t'u shërbejnë më mirë nxënësve të tyre. Aktivitetet tona në këtë fushë përfshijnë zhvillimin e programeve në përputhje me kurrikulën shkollore, që është inovative dhe tërheqëse për të rinjtë;; Po ashtu, TOKA trajnon dhe mbështetë mësuesit aktualë dhe të ardhshëm për t'i përdorur këto programe në punën e tyre me nxënës.

4. Avokim për politika dhe praktika më të mira të zhvillimit të rinisë – duke përfshirë aktivitete si formimin e Shoqatës së Organizatave të Vullnetarizmit Edukativ të Kosovës, rubriken mujore televizive, matjen e ndikimit të programeve tone në partneritet me Fakultetin e Psikologjisë, konferencat dhe inaugurimet e projekteve.